

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS
 REPUBLICA OF KOSOVO - OPSTINA SUHAREKA
 12.03.2024
 JENJO RECEIVED
 01 181 15815

Për:	Kryesuesin e Kuvendit Komunal, z.Bexhet Kuçi Kryetarin e Komunës, z.Bali Muharremaj
Datë	12.03.2024
Nga:	Grupi i Grave të Kuvendit - Suharekë Sanie Kuqi Rexhepaj – Kryetare e GGK
Lënda:	Kërkesë për pikë të rendit të ditës në mbledhjen e rregullt të III-të të Asamblesë për vitin 2024

Të nderuar,

Si Grupi i Grave të Kuvendit jemi të përkushtuar në mbështetjen e vazhdueshme dhe fuqizimin e grave përmes mekanizmave të ndryshëm.

Duke parë nga afër statistikën rreth regjistrimit të pronës së paluajtshme, konkretisht legalizimit të ndërtimeve pa leje, janë shqetësuese numrat se sa ndërtime janë legalizuar në bashkëpronësi (burrë dhe grua), e sa vetëm në emër të grave.

Nga të dhënat e ofruara nga Drejtoria për Shërbime Pronësore, Juridike dhe Kadastër:

Ndërtime të legalizuara në bashkëpronësi (burrë dhe grua)	1
Ndërtime të legalizuara në emër të grave	16

Vetëm një shtëpi është legalizuar në pronësi të përbashkët që nga viti 2019, kurse 16 ndërtime janë legalizuar në emër të grave.

Duke e parë gjendjen si të tillë, ne Grupi i Grave të Kuvendit, e kemi parë të arsyeshme të propozojmë masa afirmative që mund të ndikojnë në rritjen e këtyre shifrave.

Si Grup, duke u mbështetur në Ligjin për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, propozojmë që:

Taksa për legalizimin e ndërtimeve Shtëpive të kategorisë së I-rë dhe shtëpive të kategorisë së II-të të lirohen nga taksa e Legalizimit, për këto kategori:

1. Aplikuesit në pronësi të përbashkët (burrë dhe grua) dhe
2. Aplikueset (gratë)

Andaj, kërkojmë që ky propozim të inkadrohet si pikë e rendit të ditës për mbledhjen e III-të të rregullt të Asamblesë Komunale për vitin 2024.

GGK, ju falenderon paraprakisht për bashkëpunim!

Me respekt,

Sanie Kuqi Rexhepaj
Kryetare e Grupit të Grave